



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**  
**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të**  
**Komunës së Prishtinës, mbajtur më 17.05.2012, e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Engin Beyoglu, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

**REND DITE :**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë;
2. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues “Zona Ekonomike” në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra;
4. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të KPF-së.

**Pika e dytë**

**Behxhet Musliu** paraqiti arsyet pse është bërë ngatërrësë me rastin e dërgimit të arsyetimit të këtij propozimi.

**Valentin Junçaj** bëri prezantimin e Plani rregullues “Zona Ekonomike” në Prishtinë.

**Shefqet Sylejmani** tha se nëse janë përfillur të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe, në anën tjetër, ka kaluar dhe në diskutim me qytetarët dhe në komitetin përkatës, ne nuk kemi arsye të mos e përkrahim këtë plan, andaj si grupi ynë parlamentar e mbështet këtë propozim.

**Kryesuesi** pyeti lidhur me qasjen në njërën nga rrugët në këtë zonë, duke shtuar se nëse mungon qasja, atëherë ajo duhet të bëhet.

**Valentin Junçaj** u përgjigj në pyetjen e parashtruar.

**Mustafë Krasniqi** tha se kjo zonë në pjesën ku kufizohet me fshatin Shkabaj, duhet të jetë edhe një qasje shumë më e shkurtër. Ai e vlerësoi lart e bërë rreth këtij plani rregullues. Në komitetin përkatës, lidhur me këtë janë mbajtur 4-5 takime. Në takimin e fundit të gjithë anëtarët e komitetit e kanë përkrahur atë, me kërkesë që të bëhet harmonizimi i koeficientit me atë të lagjes “Arbëria 3” .

**Shemsi Veseli** shtoi se nuk po thuhet se cilat janë kërkesat e qytetarëve, cilat janë realizuar e cilat jo. Nuk ka asnjë fjalë se cili është grupi i ekspertëve dhe cila është arsyeja që komisioni nuk ka vazhduar punën. Në aspektin juridik, është dashtë që së pari të merret vendim për revidimin e vendimit të mëparshëm të vitit 2008, në të cilin janë paraparë 620 ha, ndërsa në këtë propozim janë paraparë 574 ha.

**Behxhet Musliu** paraqiti sqarime shtesë.

**Tefik Mehmeti** tha se për sa i përket qasjes së rrugës, të cilën e paraqiti kryesuesi, ajo nuk do të duhet të ishte problem, por kërkesa e qytetarëve është gjithnjë rritja e koeficientit. Është insistuar që ata qytetarë të cilët kanë qenë më të ndërgjegjshëm dhe nuk kanë ndërtuar pa leje, të mos ndëshkohen, por të gjendet një koeficient i kënaqshëm edhe për ta. Ky propozim është i mirë dhe besoj se edhe për qasjen në rrugë do të gjendet alternativë.

**Agim Salihu** paraqiti plotësime në aspektin e hartimit të vendimit.

**Behxhet Musliu** paraqiti sqarime shtesë lidhur me kufijtë e këtij plani.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues “Zona Ekonomike” në Prishtinë, me ndryshime, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e tretë**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Gashi**.

**Shefqet Sylejmani** u shpreh në mbështetje të këtij propozimi.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve tjera të egra, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e katërt**

##### **Të ndryshme**

**Shefqet Sylejmani** tha se asgjë nuk është bërë në përmbushjen e obligimeve në lagjen “Tophane” dhe lidhur me linjën e kërkuar për autobus, dhe shtoi se kjo mos kryerje e punëve është më tepër se fatkeqësi.

**Tefik Mehmeti** tha se është shumë e paarsyeshme thënia se gropat në rrugë do të mbyllen me një tender. Kompania e cila i dëmton rrugët, është mirë që të ngarkohet me taksë për çdo ditë që i len gropat pa u mbuluar.

**Agim Gashi** paraqiti disa sqarime lidhur me linjën për autobus dhe lënien e gropave të hapura.

**Behxhet Musliu** paraqiti sqarime nga lëmi i urbanizmit.

*Mbledhja mbaroi në orën 16:30.*

**Procesmbajtësja**  
**Alije Gusia**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**